



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 5 maj 2014  
Nr.ref.:RK 576/14

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI221/13**

Parashtrues

**Shaqir Përvetica**

**Kërkesë për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri, të  
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,  
Rasti nr. KI67/13, i 12 shtatorit 2013**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Shaqir Përvetica, me vendbanim në Prishtinë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Në kërkesën e tanishme, parashtruesi nuk ka specifikuar se cilin vendim dëshiron ta kontestojë. Parashtruesi në përgjithësi iu është drejtuar disa autoriteteve gjyqësore, respektivisht kryetarëve të këtyre institucioneve, duke përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është kërkesa për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të Rastit nr. KI67/13, të 12 shtatorit 2013, që kishte të bënte me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 228/2012, të 12 marsit 2013.
4. Në kërkesën e tanishme, parashtruesi nuk ka specifikuar ndonjë shkelje konkrete të dispozitave kushtetuese.

## **Baza juridike**

5. Rregulli 36 (3) e) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 9 dhjetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 27 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendim nr. GJR. 221/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendim nr. KSH. 221/13, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Prof. dr. Enver Hasani.
8. Më 27 janar 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe kërkoi plotësimin e kërkesës me dokumentacion relevant.
9. Sipas nenit 22.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi nga dita e konfirmimit të shkresës, ka pesëmbëdhjetë (15) ditë afat kohor për të plotësuar kërkesën e tij me dokumentacionin relevant, të kërkuar nga Gjykata, por kjo procedurë nuk është respektuar edhe pas kalimit të afatit të paraparë me Ligj.
10. Më 14 mars 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Kërkesa e tanishme e parashtruesit, përkitazi me rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri në Rastin KI67/13, të 12 shtatorit 2013, numëron faktet në vijim: vendimet e Gjykatës Komunale, C1. nr. 46/2002, të 10 shtatorit 2002, dhe C1. nr. 05/2008, të 1 prillit 2009, si dhe vendimet e Gjykatës së Qarkut të

Prishtinës, Ac. nr. 592/2002, të 1 shkurtit 2005, dhe Ac. nr. 56/2006, të 21 nëntorit 2007.

12. Gjykata vëren se, në vendimin e mëparshëm, Rasti KI67/13, rezultojnë po të njëjtat fakte të cilat Gjykata i ka shqyrtuar në seancën e Kolegjit shqyrtues të 12 shtatorit 2013. Në vijim, vendimet e gjykatave të rregullta që janë shqyrtuar në rastin e mëparshëm:

*“Më 10 shtator 2002, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte nxjerr Aktvendimin C. nr. 46/02, me të cilin e kishte hedhur poshtë padinë e parashtruesit, si të paafatshme. Gjykata në fjalë kishte konstatuar se padia ishte ushtruar jashtë afatit të paraparë me ligj.*

*Më 1 shkurt 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktvendimin Ac. nr. 592/2002, prishi Aktvendimin C. nr. 46/02, të 10 shtatorit 2002, të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe lëndën ia kthej së njëjtës gjykatë për rigjykim.*

*Më 6 qershor 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin C. nr. 130/05), hodhi poshtë, padinë e parashtruesit, si të paafatshme, nga shkak se parashtruesi e kishte lëshuar afatin ligjor për dorëzimin e padisë.*

*Më 21 nëntor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, nxori Aktvendimin Ac. nr. 56/2006), me të cilin e prishi Aktvendimin C. nr. 130/05, të 6 qershorit 2005, të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe vendosi që lëndën t’ia kthej gjykatës së instancës së parë për rigjykim.*

*Më 1 prill 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi Cl. nr. 05/2008) vendosi për ndërprerjen e gjykimit të mëtejme të kësaj çështje kontestuese, “për shkak se KHT Kosova ish Sloga në Prishtinë, sipas gjykatës në fjalë ishte privatizuar dhe se likuidimi i ndërmarrjes së lartcekur kishte hyrë në fuqi më 11 prill 2007. Bazë për ndërprerjen e kësaj çështjeje ishte parashtruesi e 4 qershorit 2007 e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e cila i kishte propozuar Gjykatës Komunale në Prishtinë, ndërprerjen e procedurave gjyqësore kundër ndërmarrjes së paditur, sepse e njëjta është privatizuar dhe se procesi i likuidimit të saj ka hyrë në fuqi nga 11 prilli 2007.*

*Më 20 korrik 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 1178/2009), përfundimisht e refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, Cl. nr. 05/08, të 27 korrikut 2009, me të cilin ishte hedhur poshtë padia e parashtruesit si e jashtafatshme. Kolegji i Gjykatës së Qarkut, pas shqyrtimit të rastit, ka konstatuar se instanca e shkallës së parë Aktvendimin Cl. nr. 05/08, të 1 prillit 2009, ia kishte dorëzuar parashtruesit më 2 prill 2009, gjersa përfaqësuesi i parashtruesit ankesën e kishte parashtruar më 30 qershor 2009, që sipas vlerësimit të kolegjit të asaj gjykate, ankesa është parashtruar jashtë afatit të paraparë me dispozitat ligjore.*

Më 12 mars 2013, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 228/2012) refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 1178/2009, të 20 korrikut 2009. Gjykata Supreme vendimin e saj e arsyeton si në vijim: “Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore kur ka gjetur se ankesa është e pasafatshme”.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

13. Parashtruesi i kërkesës ankohet kryesisht për joefikasitetin e punës së sistemit gjyqësor në veçanti dhe të sistemit të drejtësisë në përgjithësi, duke supozuar në joprofesionalizmin e vendimmarrjes së gjyqësorit.
14. Parashtruesi nuk ka qartësuar se çfarë dëshiron të arrijë me kërkesën e tanishme dhe nuk shpjegon se cili është qëllimi i parashtrimit të kësaj kërkesë. Ai vetëm shpreh pakënaqësi ndaj disa prej vendimeve të gjykatave të rregullta, ku ka nënvizuar në to pohimet e gjykatave duke i quajtur si gjetje të pavërteta. Parashtruesi ankohet edhe ndaj Aktvendimit për papranueshmëri të Rastit nr. KI67/13, të 12 shtatorit 2013, të Gjykatës Kushtetuese.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

15. Gjykata Kushtetuese, para se ta shqyrtojë kërkesën e parashtruar, së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
16. Parashtruesi në kërkesën e tanishme ankohet kundër vendimeve të autoriteteve gjyqësore në përgjithësi, duke përfshirë edhe Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin nr. KI67/13, të 12 shtatorit 2013, të Gjykatës Kushtetuese.
17. Gjykata Kushtetuese, për rastin në fjalë, më 12 shtator 2003, njëzëri kishte vendosur për papranueshmërinë e kërkesës, për arsyet e mëposhtme:

*“Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës ankohet vetëm ndaj vendimeve të gjykatave të rregullta, përkitazi me konstatimin se ankesa nuk ishte parashtruar brenda afatit ligjor siç kërkohet me dispozitat e ligjit të aplikueshëm.*

*Gjykata rikujton se nuk është detyrë e saj që të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të dhëna nga gjykatat e rregullta, përveç nëse vendimet e tilla janë nxjerrë në mënyrë arbitrare dhe të paarsyeshme.*

*Detyra e Gjykatës është që të vlerësojë nëse procedurat, në tërësinë e tyre, kanë qenë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Pra, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).*

*Në rastin konkret, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë provë prima facie që tregon se shkeljet e supozuara të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).*

*Prandaj, Gjykata nuk mund të konsideroj se procedurat përkatëse të zhvilluara në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, mutatis mutandis, Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).*

*Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush të gjitha kriteret e pranueshmërisë, dhe prandaj, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) a) dhe b) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe e papranueshme”.*

18. Në rastin konkret, vërehet qartë se kërkesa e tanishme e parashtruesit nuk paraqet prova të reja apo ndonjë pretendim të ri për shkeljen e të drejtave themelore të parashtruesit të garantuara me Kushtetutë.
19. Këtë kërkesë të parashtruesit, Gjykata nuk mund ta konsideroj si kërkesë të re, pasi që përkitazi me argumentet e ngritura në kërkesën e tanishme, Gjykata, tashmë ka vendosur me Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin Nr. KI67/13 të 12 shtatorit 2013.
20. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) pikës f) të Rregullores së punës, që përcakton se:

*36 (3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*

*f) kërkesa nuk është racione materiae në pajtim me Kushtetutën;*

21. Në këtë kontekst, kërkesa e tanishme nuk i përmbush kriteret e kërkuara me rregullin e lartcekur, për arsye se Gjykata nuk ka juridiksion që të vendos për çështjet juridike për të cilat njëherë ka vendosur.
22. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, përkitazi me kërkesat individuale është përcaktuar qartë me nenin 113.7 të Kushtetutës. Me akte individuale të autoriteteve publike në kuptim të nenit 113.7, duhet nënkuptuar të gjitha aktet individuale të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, që paraqesin objekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë sipas kuptimit të këtij neni, përveç atyre të vetë Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, duhet kuptuar qartë dhe drejtë se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion që t'i rihap dhe gjykoj vendimet e saj për të cilat njëherë ka vendosur.

23. Gjkata Kushtetuese dëshiron të rikujtojë se vendimet e saj janë vendime të fuqisë së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe të për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.
24. Përkitazi me këtë, neni 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] i Kushtetutës, përcakton: *“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”*.
25. Palët me kërkesën e tyre mund të kërkojnë nga Gjykata, korrigjimin e gabimeve teknike dhe numerike, kushtimisht të lëshuara në vendimet e saj.
26. Përkitazi me këtë, rregulli 61 i Rregullores së punës përcakton:
- 1) *“Gjykata, ex officio, ose pas kërkesës nga pala, e cila bëhet brenda dy javësh nga dërgimi i aktgjykimit apo i vendimit, mund ta korrigjojë ndonjë gabim teknik ose numerik që është bërë në aktgjykim ose në vendim”*.
- 2) *“Urdhri për korrigjim i bashkëngjitet origjinalit të aktgjykimit ose vendimit të korrigjuar”*.
27. Si përfundim, Gjykata gjen se, kërkesa e parashtruesit nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, prandaj në pajtim me rregullin 36 (3) pika f) duhet hedhur poshtë si e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (3) f) si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores, më 14 mars 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani